19540

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. ________Vendimit

# V E N D I M
## PER RREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane sot me date 3.6.1998 une gjyqtare e gjykates se rrethit Tirane Marjana Dedi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Ilir Hoxha per rregjistrimin si person juridik te shoqerise tregetare " HOXHA " SHPK dhe

## K O N S T A T O V A

Se kerkesa e paraqitur nga kerkuesi Ilir Hoxha per rregjistrimin si person juridik te shoqerise tregetare " HOXHA " SHPK me administrator z. Ilir Hoxha me kapital fillestar 100.000 leke me kohezgjatje 10 vjet me seli ne qytetin e Pogradecit lagja nr. 3 me objekt te veprimtarise ne fushen e ruajtjes se objekteve ne pronesi ose ne perdorim te personave juridik, fizike, shqiptar e te huaj, ruajtjen e rendit ne keto objekte dhe sigurimin e jetes se personelit e te vlerave pasurore te tyre gjate levizjes, eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

## PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr. 7667 date 28.1.1993 dhe te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992

## V E N D O S A

RRegjistrimin si person juridik te shoqerise tregetare " HOXHA " SHPK me ortak te vetem kerkuesin Ilir Hoxha me administrator z. Ilir Hoxha me kapital fillestar 100.000 leke me kohezgjatje mbi 10 vjet me seli ne qytetin e Pogradecit lagja nr. 3 me objekt te veprimtarise ne fushen e ruajtjes se objekteve ne pronesi ose ne perdorim te personave juridike e fizike, shqiptar e te huaj, ruajtja e rendit ne keto objekte dhe sigurimin e jetes se personelit e te vlerave pasurore te tyre gjate levizjes.

Kunder vendimit lejohet ankim.

GJYQTARE
MARJANA DEDI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 19540 Vendimit

## VENDIM
## PER RREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane sot me date 3.6.1998 une gjyqtare e gjykates se rrethit Tirane Marjana Dedi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Ilir Hoxha per rregjistrimin si person juridik te shoqerise tregetare " HOXHA " SHPK dhe

## KONSTATOVA

Se kerkesa e paraqitur nga kerkuesi Ilir Hoxha per rregjistrimin si person juridik te shoqerise tregetare " HOXHA " SHPK me administrator z. Ilir Hoxha me kapital fillestar 100.000 leke me kohezgjatje 10 vjet me seli ne qytetin e Pogradecit lagja nr. 3 me objekt te veprimtarise ne fushen e ruajtjes se objekteve ne pronesi ose ne perdorim te personave juridik, fizike, shqiptar e te huaj, ruajtjen e rendit ne keto objekte dhe sigurimin e jetes se personelit e te vlerave pasurore te tyre gjate levizjes, eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

## PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr. 7667 date 28.1.1993 dhe te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992

## VENDOSA

RRegjistrimin si person juridik te shoqerise tregetare " HOXHA " SHPK me ortak te vetem kerkuesin Ilir Hoxha me administrator z. Ilir Hoxha me kapital fillestar 100.000 leke me kohezgjatje mbi 10 vjet me seli ne qytetin e Pogradecit lagja nr. 3 me objekt te veprimtarise ne fushen e ruajtjes se objekteve ne pronesi ose ne perdorim te personave juridike e fizike, shqiptar e te huaj, ruajtja e rendit ne keto objekte dhe sigurimi e jetes se personelit e te vlerave pasurore te tyre gjate levizjes.

Kunder vendimit lejohet ankim.

GJYQTARE
MARJANA DEDI

SH.P.K" I R A L "
P O G R A D E C

# V E N D I M

Nr. 1 date 30.08.2001

Me vendimin e Gjykates te Rrethit Tirane nr.19540 te dates 03.06.1998, eshte regjistruar si Person Juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar" HOXHA " SH.P.K me ortak te vetem dhe administrator Ilir Njazi HOXHA me seli ne Lagjen nr.3 te qytetit Pogradec, dhe me kapital 100000 leke,me kohzgjatje mbi 10 vjet dhe me objekt te veprimtaris se saj:

*"Sherbimi i ruajtjes dhe i sigurise fizike :per sigurimin e objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizik e juridik me veprimtari ne Republiken e Shqiperise,sigurimin dhe mbrojtjen e jetes e shendetit te personave fizike , shtetas shqipetar ose te huaj , qe kerkojne mbrojtjen e objekteve e te jetes se tyre."*

Ne baze te Ligjit nr.8770 date 19.04.2001 "Per shoqerit e Sigurimit e te ruajtjes fizike " si dhe te Udhezimeve te Ministris se Rendit Publik Nr.1487,1488,1489,1490,1491,1492, te dates 21.06.2001 :

V E N D O S U R:

- ***Te ndryshoj emerin e shoqerise nga" Hoxha" ne"IRAL" SH.P.K.***
- ***Te caktoj drejtusin teknik te shoqerose "I R A L " Sh.p.k: z.Kristaq Pasko DIVJAKA:***
- ***Shtimi i kapitalit themeltar te shoqerise nga 100000 leke (njeqimd mije ) ne 4000000 leke (kater milion ),ne baze te kerkesave te caktuara nga ligji.***

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

ADMINISTRATORI

( Ilir Njazi HOXHA )

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA POGRADEC
No.1970 rep.

## V E R T E T I M

Sot më datë 20 Shtator 2001 , u paraqit përpara meje noter Thoma Bicja personalisht z. Ilir Njazi HOXHA ,për identitetin e të cileve u njoha nëpërmjet dokumetit të indentifikimit,i cili më deklaroi se jashtë kësaj zyre është përgatitur Vendimi të cilin e nënshkrojten rregullisht me vullnet të lirë atë para meje të cilën unë e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTER

( Thoma Bicja )

PULLE TAKSE 50 LEKE R. SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RETHIT TIRANE
Nr.19540/1

**VENDIM**

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me daten 15/10 2001, une gjyqtarja e Gjykates se Rethit Tirane Xiokua, si shqyrtova kerkesen e kerkuesit Ilir Njazi HOXhA, Ortaku I vetem dhe administrator **I SH.P. K. " HOXHA"** I cili kerkon te depozitoje vendimin e ortakut te vetem nr.1 date 30.08.2001 dhe:

KONSTATOVA

Kerkuesit Ilir Njazi HOXHA ortak I vetem e administrator me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr.19540 te dates 3.6.1998, Person Juridik "HOXHA" SH.P.K me seli ne Lagjen nr.3, qytetit Pogradec,me kapital 100000 leke dhe me kohezgjatje mbi 10 vjet.Me objekt te veprimtaris

*"Sherbimi I ruajtjes dhe I sigurise fizike :per sigurimin e objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizik e juridik me veprimtari ne Repubfiken e Sshqiperise,sigurimin dhe mbrojtjen e jetes e mbrojtjen e objekteve e te jetes se tyre."*

Me vendimin nr.1 date 30.08.2001 ka vendosur:

-Te ndryshoj emrin e shoqerise nga "HOXHA"ne **" IRAL" SH.P K**.

-Te caktoj drejtuesin teknik te shoqerise **"I R A L"** Sh.p.k: z Kristaq Pasko

**DIVJAKA:**

-Shtimi I kapitalit themeltar te shoqerise nga 100000 leke (njeqind mije) ne 4000000 leke (kater milion), ne baze te kerkesave te caktuara nga ligji.

Per sa me siper, nga materialet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe si e tille duhet pranuar :

**PER KETO ARSYE :**

Ne baze te ligjit nr.7667 "Per regjistrin tregetar"dhe formalitete qe duhen respektuar nga shoqerit tregetare:

**VENDOSA:**

Pranimin e kerkeses per depozitimin e Vendimit te ortakut te vetem te shoqerise **"HOXHA" SH.P.K**. ne nr.1 dt. 20.08.2001 ku eshte vendosur :

-Te ndryshoje emrin e shoqerise nga "Hoxha" ne **"IRAL"SH.P.K.**

-Te caktoje drejtuesin teknik te shoqerise "I R A L" Sh.p.k: z. Krisaq Pasko

**DIVJAKA:**

-Shtimi I kapitalit themeltar te shoqerise nga 100000 leke (njeqind mije) ne 4000000 leke

(kater milion ),ne baze te kerkesave te caktuara nga ligji.

Urdherimin e zyres se regjistrit tregetar te Gjykates Tirane te beje ndryshimet.Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe

GJYQTARE

Alma Xiokua

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RETHIT TIRANE
Nr.19540/1

**VENDIM**
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me daten 15/10/ 2001,une gjyqtarja e Gjykates se Rethit Tirane ________, si shqyrtova kerkesen e kerkuesit Ilir Njazi HOXhA, Ortaku I vetem dhe administrator **I SH.P. K. " HOXHA"** I cili kerkon te depozitoje vendimin e ortakut te vetem nr.1 date 30.08.2001 dhe:

KONSTATOVA

Kerkuesit Ilir Njazi HOXHA ortak I vetem e administrator me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr.19540 te dates 3.6.1998, Person Juridik "HOXHA" SH.P.K me seli ne Lagjen nr.3, qytetit Pogradec,me kapital 100000 leke dhe me kohezgjatje mbi 10 vjet.Me objekt te veprimtaris

*"Sherbimi I ruajtjes dhe I sigurise fizike :per sigurimin e objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizik e juridik me veprimtari ne Republiken e Sshqiperise,sigurimin dhe mbrojtjen e jetes e mbrojtjen e objekteve e te jetes se tyre."*

Me vendimin nr.1 date 30.08.2001 ka vendosur:

-Te ndryshoj emrin e shoqerise nga "HOXHA"ne " **IRAL" SH.P K.**

-Te caktoj drejtuesin teknik te shoqerise **"I R A L"** Sh.p.k: z Kristaq Pasko **DIVJAKA:**

-Shtimi I kapitalit themeltar te shoqerise nga 100000 leke (njeqind mije) ne 4000000 leke (kater milion), ne baze te kerkesave te caktuara nga ligji.

Per sa me siper, nga materialet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe si e tille duhet pranuar :

**PER KETO ARSYE :**

Ne baze te ligjit nr.7667 "Per regjistrin tregetar"dhe formalitete qe duhen respektuar nga shoqerit tregetare:

**VENDOSA:**

Pranimin e kerkeses per depozitimin e Vendimit te ortakut te vetem te shoqerise **"HOXHA" SH.P.K.** ne nr.1 dt. 20.08.2001 ku eshte vendosur :

-Te ndryshoje emrin e shoqerise nga "Hoxha" ne **"IRAL"SH.P.K.**

-Te caktoje drejtuesin teknik te shoqerise "I R A L" Sh.p.k: z. Krisaq Pasko **DIVJAKA:**

-Shtimi I kapitalit themeltar te shoqerise nga 100000 leke (njeqind mije) ne 4000000 leke
(kater milion ),ne baze te kerkesave te caktuara nga ligji.

Urdherimin e zyres se regjistrit tregetar te Gjykates Tirane te beje ndryshimet.Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe

**GJYQTARE**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RETHIT TIRANE
Nr.19540/2

# VENDIM
# I GJYGJTARIT TE VETEM

Sot me daten 21/10/-2002, une gjygjtarja e Gjykates se Rethit Tirane ------ si shqyrtova kerkesen e kerkuesit Ilir Njazi Hoxha.Ortaku I vetem dhe administrator i **SH.P.K. "IRAL"** i cili kerkon te depozitoje vendimin e ortakut te vetem nr.2 date 20.10.2002 dhe:

KONSTATOVA

Kerkuesit Ilir Njazi Hoxha ortak i vetem e administrator me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr.19540 te dates 3.6.1998, Person Juridik "IRAL" SH.P.K me seli ne lagjen nr.3, te qytetit Pogradec, me kapital 4000000 leke dhe me kohesgjatje mbi 10 vjet.me objekt te veprimtarise

*"Sherbuimi i ruajtjes dhe sigurise fizike ;per sigurimin e objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike e juridike me veprimtari ne Republiken e Shqiperise.sigurimin dhe mbrojtjen e jetes e mbrojtjen e objekteve te jetes se tyre"*

Me vendimin nr.2 date 20.10.2002 ka vendosur:

-Te caktoje drejtuesin teknik te shoqerise **"IRAL"** Sh.p.k: z.Petrit Isa **DIKO**:

Per sa me siper, nga materialet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe si e tille duhet pranuar:

**PER KETO ARSYE:**

Ne baze te ligjit nr.7667 "Per regjistrin tregetar" dhe formalitete qe duhen respektuar nga shoqerite tregetare:

**VENDOSA:**

Pranimin e kerkeses per depozitimin e Vendimit te ortakut te vetem te shoqerise**"IRAL" SH.P.K** ne nr.2 dt.20.10.2002 ku eshte vendosur:
-Te caktoje drejtuesin teknik te shoqerise "IRAL"Sh.p.k:z.Petrit Isa **DIKO**

Urdherimin e zyres se regjistrit tregtar te Gjykates te beje ndryshimet.Te ndahen regjistrimet nga njeri-tjetri me vije te kuqe.

**GJYQTARE**

PULLE TAKSE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RETHIT TIRANE
Nr.19540/2

# VENDIM
## I GJYGJTARIT TE VETEM

Sot me daten 31/10/ 2002, une gjygjtarja e Gjykates se Rethit Tirane ------------ si shqyrtova kerkesen e kerkuesit Ilir Njazi Hoxha. Ortaku I vetem dhe administrator SH.P.K. "IRAL" i cili kerkon te depozitoje vendimin e ortakut te vetem nr.2 date 20.10.2002 dhe:

KONSTATOVA

Kerkuesit Ilir Njazi Hoxha ortak i vetem e administrator me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr.19540 te dates 3.6.1998. Person Juridik "IRAL" SH.P.K me seli ne lagjen nr.3. te qytetit Pogradec. me kapital 4000000 leke dhe me kohesgjatje mbi 10 vjet.me objekt te veprimtarise

*"Sherbimi i ruajtjes dhe sigurise fizike :per sigurimin e objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike e juridike me veprimtari ne Republiken e Shqiperise.sigurimin dhe mbrojtjen e jetes e mbrojtjen e objekteve te jetes se tyre"*

Me vendimin nr.2 date 20.10.2002 ka vendosur:

-Te caktoje drejtuesin teknik te shoqerise **"IRAL"** Sh.p.k: z.Petrit Isa **DIKO**:

Per sa me siper. nga materialet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe si e tille duhet pranuar:

**PER KETO ARSYE:**

Ne baze te ligjit nr.7667 "Per regjistrin tregetar" dhe formalitete qe duhen respektuar nga shoqerite tregetare:

**VENDOSA:**

Pranimin e kerkeses per depozitimin e Vendimit te ortakut te vetem te shoqerise **"IRAL" SH.P.K** ne nr.2 dt.20.10.2002 ku eshte vendosur:

-Te caktoje drejtuesin teknik te shoqerise "IRAL" Sh.p.k:z.Petrit Isa **DIKO**

Urdherimin e zyres se regjistrit tregtar te Gjykates te beje ndryshimet.Te ndahen regjistrimet nga njeri-tjetri me vije te kuqe.

**GJYQTARE**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 19540/3

Tirane me 10/12/.2002

**VENDIM I**
**GJYQTARIT TE VETEM**

Ne Tirane, sot me dt 20/12/. 2002, une gjyqtarja e gjykates se rrethit Tirane mbasi mora ne shqyrtim kerkesen dhe dokumentet e paraqitur nga kerkuesi z. Ilir Hoxha, administrator I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "**IRAL** " SHPK

**KONSTATOVA SE:**

Me vendimin Nr.19540 date 3.06.1998 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane eshte rregjistruar si person juridik Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "**IRAL**" SHPK, me ortak te vetem dhe administrator z Ilir Hoxha.
Me vendimin nr 3 date 10.12.2002 te ortakut te vetem te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "**IRAL**"shpk. u vendos:
Largimi i drejtuesit teknik z. Petrit Isa Diko dhe emerimi i z. Ilir Hoxha si drejtues teknik i shoqerise"**IRAL**"shpk
Ne perfundim kerkesa dhe aktet e tjera jane te bazuara ne ligj e si te tilla duhen pranuar.

**PER KETO ARSYE**

Gjykata konform nenit 24 te ligjit 7667 dt. 28.01.1993"Per Regjistrin Tregtar" dhe Ligjit Nr 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare"

**VENDOSA :**

Pranimin e kerkeses.
Depozitimin e vendimit nr 3 date 10.12.2002 te ortakut te vetem te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "**IRAL**"shpk.
Urdherimin e zyres se regjistrit tregtar te beje ndryshimet perkatese ne kollonen
Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe
Kunder vendimit lejohet ankim .

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr.______

PULLE TAKSE 100 LEKE SHQIPERISE

Tirane me __/12.2002

VENDIM I
GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane, sot me dt __/12/2002, une gjyqtarja e gjykates se rrethit Tirane mbasi mora ne shqyrtim kerkesen dhe dokumentet e paraqitur nga kerkuesi z. Ilir Hoxha, administrator I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "**IRAL** " SHPK

KONSTATOVA SE:

Me vendimin Nr.19540 date 3.06.1998 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane eshte rregjistruar si person juridik Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "**IRAL**" SHPK, me ortak te vetem dhe administrator z Ilir Hoxha.
Me vendimin nr 3 date 10.12.2002 te ortakut te vetem te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "**IRAL**"shpk. u vendos:
Largimi i drejtuesit teknik z. Petrit Isa Diko dhe emerimi i z. Ilir Hoxha si drejtues teknik i shoqerise"**IRAL**"shpk
Ne perfundim kerkesa dhe aktet e tjera jane te bazuara ne ligj e si te tilla duhen pranuar.

PER KETO ARSYE

Gjykata konform nenit 24 te ligjit 7667 dt. 28.01.1993"Per Regjistrin Tregtar" dhe Ligjit Nr 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare"

VENDOSA :

Pranimin e kerkeses.
Depozitimin e vendimit nr 3 date 10.12.2002 te ortakut te vetem te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "**IRAL**"shpk.
Urdherimin e zyres se regjistrit tregtar te beje ndryshimet perkatese ne kollonen
Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe
Kunder vendimit lejohet ankim .

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE - GJYKATA E SHKALLES SE PARE - TIRANE

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANË**
**Nr. 19.540 / 4 i Vendimit**

# VENDIM
## I GJYQTARIT TË VETËM

Sot në datën 18.01.2006 unë Gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Tiranë A. Caco, mbasi u njoha me kërkesën e kërkuesit Adil AGOLLI, Administrator i shoqërisë " IRAL " Shpk Pogradec, i cili kërkon që të depozitohet Vendimi i ortakut të vetëm të shoqërisë Nr. 4 datë 30.12.2005, nga

**Konstatova:**

Shoqëria " IRAL " Shpk është rregjistruar për të ushtruar aktivitet në qytetin e Pogradecit me Vendimin e Gjykatës së Tiranës me Nr. 19.540 datë 03.06.1998, e themeluar nga ortaku i vetëm Ilir HOXHA, me emërtimin e parë " HOXHA" Shpk, i ndryshuar me Vendimin Nr 19.540/1 datë 15.10.2001, me kapital themeltar prej 100.000 lekë i zmadhuar në 4.000.000 lekë po me vendimin e cituar, me objekt veprimtarie " Në fushën e ruajtjes së objekteve në pronësi ose në përdorim të personave juridike e fizike, shqiptar dhe të huaj, ruajtja e rendit në këto objekte dhe sigurimi i jetës së personelit e tyë vlerave pasurore të tyre gjatë lëvizjes ".

Me Vendimin e ortakut të vetëm të shoqërisë Nr. 4 datë 30.12.2005, është bërë miratimi i Kontratës së Dhurimit Nr. 193 rep. 47 kol. datë 30.12.2005, ku ortaku Ilir HOXHA, dhuron 100 % të kapitalit themeltar të nënshkruar të shoqërisë duke u larguar nga shoqëria, dhe përfituesi Adil AGOLLI, që përfiton 100 % të kapitalit themeltar dhe bëhet ortak i vetëm në shoqërinë " IRAL " Shpk. Me këtë rast është emëruar Administrator i shoqërisë z. ADIL AGOLLI.

Përsa më sipër, mbeshtetur mbi gjykimin e bërë, dokumentacionin e paraqitur për këtë qëllim, kërkesa është e drejtë dhe si e tille duhet pranuar.

**PER KETO ARSYE:**

në bazë të ligjit nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare" dhe ligjit 7667 datë 26.1.1993 "Për rregjistrin tregëtar "

**VENDOSA**

1-Pranimin e kërkesës për depozitimin e vendimit të ortakut të vetëm Nr. 4 të datës 30.12.2005 dhe kontratën e Dhurimit Nr. 193 rep. 47 kol datë 30.12.2005, me të cilat është vendosur e realizuar -Dhurimi i 100 % e Kapitalit themeltar të nënshkruar prej 4.000.000 lek, nga ish ortaku Ilir HOXHA, i cili largohet nga shoqëria, tek ortaku përfitues Adil AGOLLI, i cili përfiton 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë " IRAL " Shpk, i cili futet ne shoqëri në cilësinë e ortakut të vetëm themelues.

2-Emerohet administrator i shoqerise z. Adil AGOLLI.

Të bëhen ndryshimet në kollonën me bojë të kuqe, në skedarin e shoqërisë "IRAL" Shpk Pogradec.

Kundër vendimit lejohet ankim në shkallë të dytë.

GJYQTARE
Ariana Caco

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANË**
**Nr. 19.540 / 4 i Vendimit**

# VENDIM
# I GJYQTARIT TË VETËM

Sot në datën 16.01.2006 unë Gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Tiranë Ariana Caco, mbasi u njoha me kërkesën e kërkuesit Adil AGOLLI , Administrator i shoqërisë " IRAL " Shpk Pogradec , i cili kërkon që të depozitohet Vendimi i ortakut të vetëm të shoqërisë Nr. 4 datë 30.12.2005, nga

**Konstatova:**

Shoqëria " IRAL " Shpk është rregjistruar për të ushtruar aktivitet në qytetin e Pogradecit me Vendimin e Gjykatës së Tiranës me Nr. 19.540 datë 03.06.1998 , e themeluar nga ortaku i vetëm Ilir HOXHA , me emërtimin e parë " HOXHA" Shpk , i ndryshuar me Vendimin Nr 19.540/1 datë 15.10.2001, me kapital themeltar prej 100.000 lekë i zmadhuar në 4.000.000 lekë po me vendimin e cituar , me objekt veprimtarie " Në fushën e ruajtjes së objekteve në pronësi ose në përdorim të personave juridike e fizike, shqiptar dhe të huaj, ruajtja e rendit në këto objekte dhe sigurimi i jetës së personelit e tyë vlerave pasurore të tyre gjatë lëvizjes ".

Me Vendimin e ortakut të vetëm të shoqërisë Nr. 4 datë 30.12.2005, është bërë miratimi i Kontratës së Dhurimit Nr. 193 rep. 47 kol. datë 30.12.2005 , ku ortaku Ilir HOXHA , dhuron 100 % të kapitalit themeltar të nënshkruar të shoqërisë duke u larguar nga shoqëria, dhe përfituesi Adil AGOLLI , që përfiton 100 % të kapitalit themeltar dhe bëhet ortak i vetëm në shoqërinë " IRAL " Shpk. Me këtë rast është emëruar Administrator i shoqërisë z. ADIL AGOLLI .

Përsa më sipër, mbeshtetur mbi gjykimin e bërë, dokumentacionin e paraqitur për këtë qëllim, kërkesa është e drejtë dhe si e tille duhet pranuar.

**PER KETO ARSYE:**

në bazë të ligjit nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare" dhe ligjit 7667 datë 26.1.1993 "Për rregjistrin tregëtar "

**VENDOSA**

1-Pranimin e kërkesës për depozitimin e vendimit të ortakut të vetëm Nr. 4 të datës 30.12.2005 dhe kontratën e Dhurimit Nr. 193 rep. 47 kol datë 30.12.2005, me të cilat është vendosur e realizuar -Dhurimi i 100 % e Kapitalit themeltar të nënshkruar prej 4.000.000 lek, nga ish ortaku Ilir HOXHA , i cili largohet nga shoqëria . tek ortaku përfitues Adil AGOLLI , i cili përfiton 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë " IRAL " Shpk, i cili futet ne shoqëri në cilësinë e ortakut të vetëm themelues .

2-Emerohet administrator i shoqerise z. Adil AGOLLI .

Të bëhen ndryshimet në kollonën me bojë të kuqe, në skedarin e shoqërisë "IRAL" Shpk Pogradec .

Kundër vendimit lejohet ankim në shkallë të dytë.

**GJYQTARE**
Ariana Caco

Urdhri regjistrimi

-19540-

1)
2) a) "Hoxha" sh.p.k.
b) Pogradec, L. 3, P 65.
c) Shërbimi i rrjeve civile
ç) 100 000 lekë
Ilir Hoxha
3- Ilir Hoxha, dtl 1955, banues në Pogradec, L. 3, P 65.
4- 10 vjet
aksion 1 fl
st 5 fl
5- 2. 06. 1998
3. 06. 1998

[signature]

Mandat nr 718703.
nr llog 3622
dt 2.06.1998 Banka e Kursimeve Tiranë.

**AKT - THEMELIMI**
**PER KRIJIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**" I R A L " SH.P.K**

Sot më datë 15 .09.2001 , unë i nënshkruari Ilir Njazi HOXHA ,lindur më 10 shtator 1955 , ne qytetin e Pogradecit dhe banues ne Lagjen nr.3 te qytetit Pogradec ,me cilësinë e Ortakut të vetëm,me vullnetin tim te lire e te plote,vendosa te krijoj Shoqërinë me pregjegjesi te kufizuar " I R A L " SH.P.K me qender ne Pogradec, të cilën unë e përfaqësoj mbeshtetur ne dispozitat ligjore e nenligjore ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

H Y R J E

NENI 1

Kuptimi i këtij Akt - Themelimi është krijimi i Shoqërisë me pregjegjesi te kufizuar " I R A L " SH.P.K nga Ilir Njazi HOXHA ,ortaku i vetem themelues i kesaj shoqerie

NENI 2

Qellimi i këtij Akt - Themelimi eshte krijimi i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar " I R A L " SH.P.K me seli ne Lagjia nr.3 te qytetit Pogradec dhe me shtrirje në të gjithë rrethin e Pogradecit dhe me të drejtën e zgjerimit të mëtejshëm në degë e filiale të tjera në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë .

NENI 3

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar " I R A L " SH.P.K eshte Person Juridik dhe gjithë veprimtarinë e saj do ta realizojë në pajtim të plotë me këtë Akt - Themelim si dhe dispozitat e Statutit të Shoqërisë të mbështetura në Ligjin nr.8770 date 19.04.2001 « Per Sherbimin e Ruajtjes dhe Siguris Fizike « si dhe akteve te tjera te lesgjislacionit shqiptar ne fuqi.

NENI 4

Objekti i veprimtaris se shoqeris e te sigurimit e ruajtjes fizike " I R A L " SH.P.K do te jete :

*"Sherbimi i ruajtjes dhe i sigurise fizike :per sigurimin e objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizik e juridik me veprimtari ne Republiken e Shqiperise,sigurimin dhe mbrojtjen e jetes e shendetit te personave fizike , shtetas shqipetar ose te huaj . qe kerkojne mbrojtjen e objekteve e te jetes se tyre*

NENI 5

Shoqëria e ka emrin e saj " I R A L " SH.P.K dhe gëzon të drejtën e fillimit të veprimtarisë së saj në përputhje të plotë me objektin e mësipërm që nga momenti i miratimit të vendimit të Gjykates të rrethit Tirane si Person Juridik, si dhe paisjen me lejen e ushtrimit te profesionit nga Dega e Tatime Taksave dhe me nje kohzgjatje mbi 10 vjet.

NENI 6

Shoqëria e sigurimit e ruajtjes fizike " I R A L " SH.P.K sopas ligjit do te kete drejtues teknik z.Kristaq pasko DIVJAKA.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 7

Për të bërë të mundur zhvillimin e veprimtarisë së saj,Shoqëria e sigurimit e ruajtjes fizike " I R A L " SH.P.K ka një kapital themeltar 4 000.000 (kater milion ) lekë e ortakut te vetem Ilir Njazi Hoxha i disponueshme qindperqind e neneshkrushme dhe e shlyeshme prej tij.

BILANCI,VEPRIMTARIA EKONOMIKE,DETYRIMET.

NENI 8

Shoqeria mban pergjegjesi per te gjitha detyrimet shteterore,sigurimet shoqerore , tatime etj.

NENI 9

Ortaku i vetem themelues ose persona te tjere te autorizuar prej tij , kane te drejte qe me nxjerrjen e bilanceve ekonimike , te perfitojn perqindjet e realizuara nga veprimtaria private .

JURIDIKSIONI

NENI 10

Në veprimatrinë e saj, "I R A L " SH.P.K bazë do të ketë zbatimin të ligjit mbi mardhëniet e punësimit me qëllim që me të gjithë të

punësuarit e saj të hartojë kontrata pune paraprake dhe do të realizojë pagesat dhe sigurimet shoqerore ne pajtim te plote me to .

## DISPOZITA TE VEÇANTA

### NENI 11

Personi përgjegjës për krijimin e Shoqërisë se sigurimit e ruajtjes fizike " I R A L " SH.P.K është Ilir Njazi HOXHA, Ortak i Vetëm i Shoqërisë.

Dispozita me te hollesishme mbi organizimin e shoqerise percaktohen ne Statutin e saj .

Nuk mund te pranohet ne kete shoqeri si ortak nje person tjeter pa pelqimin e ortakut te vetem si dhe pa bere veprimet perkatese legjislative ne Vendimin e gjykates se rrethit Tirane.

Ortaku I vetem dhe te gjithe punonjesit jane te detyruar te ruajne karakterin kofidencial te aktivitetit te shoqeris.

### NENI 12

Te gjitha mosmarrveshjet me persona fizik ose juridik vendas ose te huaj si dhe organet shteterore , zgjidhen nga gjykata e rrethit.

### NENI 13

Akt - Themelimi hyn në fuqi nga çasti i nënshkrimit të tij.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

( Ilir Njazi HOXHA )

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA POGRADEC
No. 2968 rep.

## VERTETIM

Sot më datë 20 Shtator 2001 , u paraqit përpara meje noter Thoma Bicja,personalisht z. Ilir Njazi HOXHA , për identitetin e të cilit u njoha nëpërmjet dokumentit të indentifikimit,i cili më deklaroi se jashtë kësaj zyre është përgatitur Akt -Themelimi i mësipërm të cilin e nënshkroi rregullisht me vullnet të lirë atë,para meje të cilën unë e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTER

( Thoma Bicja )

PULLE TAKSE 50 LEKE R.SHQIPERISE

# A K T   T H E M E L I M I
# I S H O Q Ë R I S Ë  3 Hoxha" SHPK POGRADEC

Sot më datën ______________ unë i nënëshkruari Ilir Njazi Hoxha i biri
i Njaziut dhe i Hajries i datëlindjes 1995 banues në qytetin e Pogradec
-it, lagje Nr 3 Pallati 65 me letërnjoftimi personal EV Nr 119102 me
cilësinë e ortakut të vetëm , me vullnetin tim të lirë e të plotë vendo-
-sa të krijoj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me seli në qytetin e
Pogradecit në lagjen Nr 3 Pallati 65 kati i tretë Pogradec.

## H Y R J E

Në kuptimin e këtij akti themelimi ortaku i vetëm Ilir Njazi Hoxha ësht
themeluesi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar"Hoxha" Pogradec .
Qëllimi i këtij akti themelues është krijimi i SHPK " Hoxha" me seli në
qytetin e Pogradecit me shtrirje në të gjithë teritorin e rrethit të
Pogradecit .
SHPK " Hoxha " rregullon gjithë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë
aktthemelimi, statusin e saj në përputhje të plotë me ligjin Nr 7638
datë 19/3/1992 si dhe aktet e tjerra të legjislacionit shqiptar.

## O B J E K T I

Objekti i SHPK " Hoxha" me veprimtarinë e saj është :
-Ruajtja e objekteve në pronësi ose në përdorim të personave juridikë
a fizikë, shqiptarë a të huaj , ruajtjen e rendit në këta objekte dhe
sigurimin e jetës së personelit e të vlerave pasurore të tyre gjatë lë
-vizjes.

## AFATI I VEPRIMTARISË

Veprimtaria e SHPK " Hoxha" do të jetë efektive nga dita e regjistrimi
të saj në gjykatën e Tiranës me afat mbi 10 vjet në mbështetje të lej
përkatëse aktuale që ka SHPK nga dega e tatimeve Pogradec.

## KAPITALI FILLESTAR

Kapitali në momentin e fillimit të veprimtarisë është 100000(njëqintm
leka i miratuar tërësisht në degën e bankës së kursimeve Pogradec me
Nr llogarie ______________ nga kontributi vetiak i administratorit t
të SHPK Z. Ilir Hoxha.

## J U R I D I K S I O N I

Shoqëria " Hoxha" SHPK Ilir Hoxha Pogradec e ka qendrën në qytetin e
Pogradecit. L. 3. Pogradec p. 65
Të gjitha mosmarëveshjet me personat fizikë e juridikë vendas e të h
si dhe ndërmarjet e institucionet shtetërore zgjidhen me mirëkuptim
në të kundërt zgjidhja bëhet nëpërmjet gjykatës.

THEMELUESI ORTAK I VETËM

ILIR NJAZI HOXHA

# S T A T U T

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## "I R A L " SH.P.K

Sot me daten 15 Shtator 2001 sipas Aktit te Themelimit me cilesin e Ortakut te vetem dhe Administratorit i neneshkruari Ilir Njazi HOXHA po krijoj Statutin e shoqerise me me pergjegjesi te kufizuar "I R A L " SH.P.K me seli ne Lagjen nr. 1 Pogradec, per sherbimin e ruarjtjes e siguris fizike ne mbeshtetje te Ligjit nr.8770 date 19.04.2001 "Per shoqerin e sigurimit e ruajtjes fizike " (SH.P.R.) dhe Udhezimet e Ministris se Rendit Publik nr.1487,1488,1489.1490.1491 e 1492 te dates 26.06.2001.Aktiviteti i shoqeris do te zhvillohet duke u mbeshtetur ne dispozitat e ketij statuti i cili perben aktin baze per veprimtarin e rregullimin e struktures e organizimit.

### KREU I
### EMERTIMI SELIA OBJEKTI DHE JETGJATESIA

### NENI 1

Shoqëria e krijuar sipas Aktit te Themelimit e cila ,është pronë e ortakut të Vetëm Ilir Njazi HOXHA lindur më 10 shtator 1955, ne Korce dhe banues ne Lagjen nr.3 te qytetit Pogradec i cili do te mbeshtetet gjithmone ne baze te ligjeve ne fuqi per mbarvajtjen e shoqerise.

### NENI 2

Shoqëria " I R A L " SH.P.K është Person Juridik.

Ajo fiton të drejtën për të vepruar si Person Juridik,nga çasti i rregjistrimit në Gjykatën e Rrethit Tirane .

### NENI 3

Shoqëria e sigurimit e ruajtjes fizike " I R A L " SH.P.K ka selin e saj ne Pogradec lagjia nr.3 ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dispozitat e parashikuara në Aktin e krijimit si dhe në dispozitat e këtij Statuti e cila ka te drejten e krijimit te filialeve e degeve ,agjensive e perfaqsive ne gjith teritorin e republikes se Shqiperise.

NENI 4

Shoqëria "I R A L " SH.P.K do te ushtrojë aktivitetin e saj privat me kete objekt te veprimtarise :

*"Sherbimi i ruajtjes dhe i sigurise fizike :per sigurimin e objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizik e juridik me veprimtari ne Republiken e Shqiperise,sigurimin dhe mbrojtjen e jetes e shendetit te personave fizike , shtetas shqipetar ose te huaj , qe kerkojne mbrojtjen e objekteve e te jetes se tyre"*

NENI 5

Ajo ka të drejtë të çelë degë,përfaqësi e filiale në qytete të tjera të Shqipërisë e në vende të tjera,jashtë Shqipërisë,duke pasur parasysh kërkesat e Ligjës e Legjislacionit e vendit ku do të çelen.

NENI 6

Shoqeria e sigurimit e ruajtjes fizike ka seline ne Lagjen nr.3 Pogradec.

Shoqeria ka vulen e saj me emertimin "I R A L " SH.P.K

Shoqeria ka emblemen e saj me inicialet **SH.R.F. IRAL**

NENI 7

Kohezgjatja e veprimtarisë se shoqerisë eshte percaktuar mbi 10 vjet duke filluar nga data e registrimit te saj ,kjo periudhe mund te shkurtohet ne rast se shoqeria prishet para kohe per arsye te perligjura dhe me miratim te Gjykates se Rrethit Tirane.

NENI 8

Vend ndodhja ligjore e personave te kontraktuar nga shoqeria dhe te paisur me lejen perkatse nga organet e rendit ne raport me shoqerine eshte ajo qe rezulton nga libri ( lista ) e antareve e miratuar nga organet e rendit publik te rrethit e ato qendrore sipas ligjit. .

KAPITALI

NENI 9

Për të bërë të mundur zhvillimin e veprimtarisë së saj,Shoqëria e sigurimit e ruajtjes fizike " I R A L " SH.P.K ka një kapital themeltar 4.000.000 (kater milion ) lekë e ortakut te vetem Ilir Njazi HOXHA të disponueshme qindperqind e neneshkrushme dhe e shlyeshme prej tij ne baze te ligjit nr.8770 date 19.4.2001. Kapitali i mesiperm eshte vertetuar me dokumentat e bankes se Kursimeve Pogradec (*Vertetimi qe i bashkalidhen ketij dokumenti*).

Ortakët e mundshëm pjesëmarrës në Shoqëri ne te ardhmen, nese aktivizohen,detyrohen të likujdojnë kuotën e pjesmarrjes ne kapital,sipas përqindjes të përcaktuar në Aktin e Krijimit dhe ne cdo rrast me deshiren dhe miratimin e ortakut te vetem .

ORTAKU I VETEM
NENI 10

Shoqëria e sigurimit e ruajtjes fizike " I R A L " SH.P.K drejtohet nga ortaku i vetem Ilir Njazi HOXHA i cili eshte ne te njejten kohe dhe Administratori i shoqerise dhe **drejtuesi ligjor** qe ka te drejten per te vendosur mbi gjithcka qe lidhet me aktivitetin ,organizimin ,ndarjen e punes ,caktimin e detyrave te pergjitheshme e te vecanta ,kontrollin per zbatimin e tyre dhe marrjen e masave perkatese per mospermbushjen e rregullave nga sejcili punonjes.

Per drejtimin teknik Shoqëria e sherbimit te rojeve civile " I R A L " SH.P.K caktohet **drejtusi teknik** sipas ligjit nr.8770 date 19.4.2001 z. Kristaq Pasko DIVJAKA i cili ka detyrat e te drejtat qe percakton ligji.

Ortaku i vetem mund te delegoje kopetencat e tij personave te tjere , gjithmon me shkrim.Per problemet e ndryshme qe merret vendimi prej tij ne vendin e asanmbles ato regjistrohen ne cdo regjister te vecante .

Eshte ortaku i vetem qe ka te drejten me vendimin e tij te beje ndryshime ne statutin e shoqerise , duke patur per kete qellim detyrimin per ti evidentuar ato ne regjistrin perkates ne gjykate dhe organin e rendit Publik qe ka dhene miratimin .

KREU II
MARREDHENIET EKONOMIKO - FINANCIARE

NENI 11

Ortaku i vetem ka te drejten eksluzive te perfaqsimit te shoqerise me te tretet dhe qe perfundon lidhjet e kontrates me organet e rendit publik ,kontrata e punes me personelin dhe sherbimin qe do te kryeje si

dhe te gjitha kontratat me personat fizik e juridike te cilet kerkojne sherbimin e shoqeris "I R A L " Sh.p.k..

Drejtusi teknik ne lidhje me to ka te drejtat ekskluzive qe parcakton ligji nr.8770 date 19.04.2001.

NENI 12

Për të bërë të mundur zhvillimin e veprimtarisë së saj, Shoqëria e sigurimit e ruajtjes fizike " I R A L " SH.P.K nepermjet drejtusit teknik te saj ben pergatitjen e punonjeseve (trajnimin ) qe deshirojne te punesohen prane shoqerise si dhe ploteson te gjitha detyrimet baze ligjore per paisjen me licensen e ushtrimit te profesionit si punonjes i kualifikuar sherbimi ne perputhje me teknikat bashkohore dhe dispozitat ne fuqi.

NENI 13

Kur Shoqëria " I R A L " SH.P.K pushon veprimtarinë e saj,ne mbeshtetje te dispozitave ligjore per likujdimin e saj me Akt-Likujdimi te plote nga Eksperti Kontabel,fillimisht shlyen te gjitha detyrimet ndaj shtetit e te tretëve dhe atëherë pjesa e mbetur eshte prone e Ortakut themelues.

NENI 14

Shoqëria ka të drejtën e tjetërsimit,gëzimit,përdorimit të pasurive të saj në përputhje me qëllimin për të cilin është krijuar.

NENI 15

Shoqëria me pergjegjesi te kufizuar "I R A L " SH.P.K gëzon të drejtën e mbrojtjes së pasurive të saj,në përputhje të Legjislacionit në fuqi.

NENI 16

Shoqëria me fondet rezervë e të veçanta ka të drejtë të kryejë lirisht çdo lloj veprimtarie ekonomike-financiare,me persona fizik apo juridik,shqipëtar apo të huaj,shtetëror apo privat ne pajtim te plote me dispozitat e ketij statuti..

Përbërja ne,shumat e përgjithshme te fondeve ,burimin për krijimin e tyre,përdorimi e rregullimi i tyre vendosen nga Ortaku i Vetëm Ilir Njazi HOXHA.

Detyrimet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë ose nga mardhëniet me të tretët,mbulohen me fondet e Shoqërisë ose nga shuma suplementare që mund të likujdohen me kapitalin themeltar kur detyrimet nuk mbulohen me fonde rezervë ekzistuese.

NENI 17

Shoqëria,sipas mundësive që do t'i krijohen,ka të drejtë të investojë në ndërmarrje apo institucione të tjera qofshin këto private apo publike,të disponojë aksione në ndërmarrje të tjera,sipas dispozitave në fuqi.

NENI 18

Pasuritë e Shoqërisë pasqyrohen në bilancin e saj të shprehura në kartmonedhë ( ne leke shqiptare )dhe në natyrë:

Bilanci i vitit të parë të veprimtarisë paraqitet brenda muajit mars të vitit pasardhës dhe po kështu veprohet me bilançin e çdo viti.

Forma e bilancit dhe e llogarive do të jetë ajo që do të përcaktohet në dispozita të veçanta te ligjit mbi kontabilitetin.

NENI 19

Veprimtaria financiare e Shoqërisë mbeshtet ne aktivin dhe pasivin e pasqyruar në bilance.

Rezultatet finaciare të veprimatrisë së Shoqërisë caktohen në mbështetje të bilancit vjetor.

NENI 20

Mardhëniet e punës me punetorët që do të punësohen pranë kësaj Shoqërie do të rregullohen me kontrata individuale,të cilat do të lidhen me secilën prej tyre.

NENI 21

Paga për punën e kryer caktohet nga ortaku i vetëm në përputhje me treguesit ekonomiko-financiare.Në mbështetje të kushteve konkrete paga,për punën e kryer mund të jetë orare,ditore,javore dhe mujore.

Madhësia e shpërblimit për punën e kryer nuk kufizohet,por nuk mund të jetë më e vogël nga sa parashikohet në dispozita të veçanta për këtë qëllim .

## KREU III

## ORGANIZIMI E DREJTIMI ADMINISTRATIV

### NENI 22

Organi vendimor i Shoqërisë është Ortaku i vetëm dhe administratori Ilir Njazi HOXHA ,i cili vendos për bilanc vjetor, për ndryshimet në Akt Krijimin e në Statut,për shtimin ose pakësimin e kapitalit themeltar,për derdhjen e shumave suplementare.Ortaku i vetëm me mbylljen e veprimtarisë vjetore mbas raportit te Ekspertit Kontabel te Autorizuar njofton organin Tatimor mbi veprimtarinë vjetore.

### NENI 23

Shoqeria merr persiper dhe derdh rregullisht te gjitha detyrimet ndaj Agjensise se Sigurimeve Shoqerore si dhe ndaj Deges se Sigurimit Shendetsor per punonjesit e saj ne perputhje te plote me dispozitat ne fuqi.

### NENI 24

Mbledhja e zakonshme te stafit drejtues organizohet duke njoftuar të paktën 30 ditë më parë. Mbledhja e jashtëzakonshme organizohet sa më shpejt të jetë e mundur në kohë.

### NENI 25

Drejtimi organizativ bëhet nga Ortaku i vetëm e në rastin kur ai emëron Drejtor Administrativ,atëherë bëhet nga ky i fundit,kopetencat e të cilit përcaktohen nga Ortaku i vetëm.

### NENI 26

Për të kontrolluar veprimtarinë financiare te Shoqërisë sipas ligjit,caktohet një Ekspert Kontabël,i cili harton dhe kontrollon veprimtarinë financiare të cilat ia paraqet për miratim Ortakut të vetëm (përkatësisht Ekspert Kontabël i Miratuar ose i Autorizuar).
Në rastin e pushimit të veprimtarisë ose të riorganizimeve të Shoqërisë janë Ekspertët ata që përpilojnë aktet përkatëse dhe ia paraqesin Ortakut te vetëm për miratim .

## KREU IV

## RIORGANIZIMI DHE PUSHIMI I VEPRIMTARISE

### NENI 27

Shoqëria e sigurimit e ruajtjes fizike " I R A L " SH.P.K,duke pasur parasysh kërkesën e ligjës mbi riorganizimet dhe pushimin e veprimtarisë,atëherë Ortaku i vetëm për to vendos ;

Në rastin e pushimin e veprimtarisë përshkak se ajo nuk rezulton me fitim ose mbaron afati i parashikuar në Aktin e Themelimit atëherë Eksperti Kontabël përgatit Aktin e Likujdimit që miratohet nga Ortaku i vetëm.

Kur Shoqëria ndërpret veprimtarinë menjëherë me miratimin e Aktit të paraqitur nga Ekspertët Kontabël,në këtë rast vendoset likujdatori për shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve dhe paraqiten për miratim në Gjykatën e rrethit Tiranë për ç'rregjistrimin e Shoqërisë.

Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për rastin e riorganizimeve ose të pushimit të filialeve apo degëve të përfaqësimit.

Ne rrastet e shkrirjes se shoqerise deri ne likujdim te plote ajo do te vazhdoj aktivitetin duke njoftuar per kete qellim te tretet qe jane te siguruar me sherbimin nga shoqeria e sigurimit e ruajtjes fizike " I R A L " Sh.p.k. per te marre masa nga keta te fundit per sigurimin dhe ruajtjen e objekteve me shoqeri tjeter analoge.

### NENI 28

Per te gjitha mosmarrveshjet qe eventualisht mund te lindin gjate veprimtaris se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirkuptim,organi kopetent per zgjidhjen e tyre eshte gjykata e rrethit.

### NENI 29

Ky Statut hyn ne fuqi nga çasti i nënshkrimit të tij.

Në raste ndryshimesh ose përmirësimesh është Ortaku i vetëm i cili ka të drejtë në bazën e vendimeve që ai merr.

Ky Statut u hartua në 4 (kater) kopje.

ADMINISTRATORI

( Ilir Njazi HOXHA )

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
NOTERIA POGRADEC
No. 2965 rep.

## VERTETIM

Sot më datë 20 Shtator 2001 u paraqit përpara meje noter Thoma Bicja personalisht z. Ilir Njazi HOXHA ,shtetas shqiptar për identitetin e të cilit u njoha nëpërmjet dokumentit të indentifikimit,i cili më deklaroi se jashtë kësaj zyre është përgatitur statuti i mësipërm të cilin e nënshkroi rregullisht me vullnet të lirë atë,pranë meje të cilën unë e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTERI

( Thoma BICJA



# S T A T U T

## I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR " H O X H A "

Në bazë të ligjit Nr 7512 datë 10/8/ 1991 "Për sanksionimin e mbrojtje
e pronës private", nismës së lirë, veprimtarisë private,të privatizimit
ligjës Nr 7696 datë 7/4/1993 " Për shërbimin e rojeve civile" VKM Nr
210 , datë 10/5/1993 " për shërbimin e rojeve civile".
Sot më datën ________________ personalisht Ilir Hoxha i biri i Njaziut
i datëlindjes 1955, banues në qytetin e Pogradecit me vullnet të lirë
e të plotë krijoi Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar " Hoxha".

## K R E U I

## Dispozita të Përgjithëshme

### Neni 1

SHPK " Hoxha" ka qendrën e saj në Pogradec dhe është person Juridik
të cilën e fiton nga dita e regjistrimit në gjykatën e Tiranës. Fillon
aktivitetin e saj me regjistrimin në degën e rendit publik dhe marrjen
e lejes në degën e tatimeve dhe taksave Pogradec për zhvillimin e akti
-vitetit të përcaktuar në objektin e saj, në përputhje me aktet ligjor
e nënligjore në fuqi , si dhe ka vulën e saj dhe llogarinë likuiduese
në bankën e kursimeve Pogradec.

### Neni 2

Pozita juridike e SHPK " Hoxha " regullohen me ligj në bazë të këtij
Statuti , ligjit Nr 7696 datë 7/4/1993"Për shërbimin e rojeve civile"
VKM Nr 210 datë 10/5/1993"Për shërbimin e rojeve civile " , udhëzimi n
128 datë 17/5/1993 i Ministrit të Rendit Publik për shërbimn e rojeve
civile , regullores Nr 129 datë 18/5/1993 " Për shërbimin e rojeve ci
-le" , të ministrisë së rendit publik , nga regullat e brendëshme të
objekteve që do të sigurohen dhe të gjitha aktet ligjore në fuqi që r
-ullon veprimtarinë për shërbimin e rojeve civile.

## ~~XXXXXX~~ OBJEKTI I SHPK

### Neni 3

Objekti i veprimtarisë së SHPK " Hoxha" është ruajtja e objekteve në
pronësi ose përdorim të personave juridikë a fizikë , shqiptarë a të
huaj , ruajtjen e rendit në këto objekte dhe sigurimin e ~~xxxxx~~ jetës
personelit dhe të vlerave pasurore të tyre gjatë lëvizjes

## KAPITALI I SHOQËRISË

### Neni 4

Kapitali themeltar përbën mjetet e nevojëshme që ka në dispozicion
shoqëria për zhvillimin e aktivitetit.
Kapitali bazë prej 100000 (njëqintmijë) leka është i depozituar pran
bankës së kursimeve Pogradec.

REPUBLIKA E SHQIPERISE THOMA BICJA NOTER POGRADEC

### Neni 5

NENI 5

Në përputhje me ecirinë e aktivitetit të SHPK administratori i saj ka të drejtë të ritë ose të pakësojë kontributin e dhënë në krijimin e kapitalit themeltar, ndryshim i cili shënohet në librin e llogarisë.

Neni 6

SHPK cakton në marveshje me personat e interesuar për ruajtjen e objketeve, vlerave materiale , sigurimin e jetës së personalit apo të vlerave pasurore në lëvizje, çmime të shërbimeve që do të kryejnë.

Administratori është administrues i kapitalit themeltar e i të ardhurave të relaizuara gjatë veprimtarisë së saj, të cilat përdoren dhe disponohen nga administratori në përputhje me objektin e veprimtari-në e saj.

-Neni 7

Fondi rezervë caktohet nga administratori në përputhje me gjendjen financaire të shoqërisë.

Detyrimet që mund të lindin gjatë veprimtarisë përballohen nga fondi rezervë,fonde të tjerra që mund të krijohen me këtë rast, ose nga shuma suplementare që derdh administratori kur detyrimet nuk përballoh-en nga fondet ekzistuese.

Neni 8

Të ardhurat nga veprimtaria pasi zbriten shpenzimet e përgjithësh detyrimet tatimore, detyrimet e sigurimeve shoqërore etj disponohen lirisht nga administratori i saj pasi zbritet dhe pjesa e caktuar për krijimin e fondit rezervë.

Neni 9

Veprimtaria ekonomike e financiare pasqyrohet në librat e dokument financiare sipas ligjit të kontabilitetit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 10

Pranimi në punë i rojeve civile bëhet nga administratori në bazë të kërkesës së pronarit të objektit,pasi të jenë të paisur me dokumen përkatës të testimit dhe të jetë lidhur kontrata sipas modelarit të p -caktuar nga ministria e rendit publik, nëpërmjet organit të rendit publik dhe shoqërisë. Procedura e Testimit të rojeve dhe e lidhjes së kontratos duhet të mbarojë brenda një afati një muaj nga data e marrj së liçencës.

Neni 11

Personat që do të pranohen si roje civile duhet të plotësojnë të gjithë kërkesat e përcaktuara në nenin 5 të ligjit NR 7696 datë 7/4/9 dhe kërkesat e tjerra të përcaktuara nga vetë firma për pranimin në punë.

NOTER POGRADEC
REPUBLIKA E SHQIPERISE THOMA BICJA NOTER POGRADEC

NOTER POGRADEC



Neni 12

Organizimi i shërbimit të rojeve civile bëhet në bashkëpunim me pronarin e objekteve, në përputhje me shtrirjen e objekteve e në vartësi të numurit të rojeve civile të miratuara nga orgami i rendit publik.

Shërbimi i rojeve civile organizohet në kohë të caktuara sipas kërk-kesës e nevojeve që ka pronari për sigurimin e objekteve me vrojtim, roje fikse, patrullim brenda një sektori të caktuar, ose shoqërim gjatë lëvizjes së vlerave pasurore. Pronari i objektit në bashkëpunim me admi-nistratorin përpilon regulloren e brendëshme të objektit në zbatim të ligjit Nr 7696 datë 7/4/1993 " Për shërbimin e rojeve civile".

Për të gjitha çështjet e parashikuara në këtë nen mbahet kontrato os ose aktmarveshje e nënëshkruar nga administratori i shoqërisë e pronari privat.

Neni 13

Për ruajtjen e administrimin SHPK është e detyruar të zbatojë rregulloren e forcave të armatosura. Armatimi duhet të sigurohet në armatura e kacaforta dhe dhënja e dorzimi i armëve bëhet me libër shër-bimi.

Neni 14

SHPK është e detyruar të bëjë aftësimin personal të rojeve civile sipas formave, programit të përcaktuar në regulloren e ministrisë së rendit publik me shpenzimet e veta.

Neni 15

Planizimi i shërbimit të rojeve civile bëhet nga administratori e pasqyrohet në fletore të veçantë , i cili i udhëzon i përgatit e i kon-trollon zbatimin e detyrave të rojeve.

Neni 16

Të drejtat e detyrat e rojeve përcaktohen në kontraton individual të punës, regulloren e brendëshme të objektit dhe në ligjin Nr 7696 da 7/4/1993 , në VKM Nr 210 datë 10/5/1993, në VKM Nr 610 datë 13/12/1993 regulloren e ministrit të rendit Publik Nr 128 datë 18/5/1993, në urdh-rat e udhëzimet e administratorit tek ky statut e aktet e tjera ligjo e nëligjore për shërbimin e rojeve civile.

Neni 17

Organ vendimar dhe operativ i SHPK është administratori i SHPK"Hoxh Administratori merr vendime për ndryshimin e statuti, shtimin ose pakë-min e kapitalit, cakton strukturën organizative, pranon në punë punon-sit si roje civile e punonjës të tjerrë sipas dispozitave të [illegible] në ligj e aktet nënligjore në fuqi, vendos për pushimin e v[illegible] së shoqërisë, përfaqëson SHPK para të tretëve, organeve të rendit, në gjykarbitrazhe,

NOTER POGRADEC

gjykata e arbitrazhë, lidh kontrata në emër e llogari të SHPK dhe
ndjek zbatimin e detyrave, kryen veprimet e nevojëshme për marrjen e
liçensës nga organet kompetente dhe organizon punën e përditëshme,
kontrollon për zbatimn e detyrave të rojeve civile, merr masa deri në
largimin nga puna të rojeve civile që shkelin detyrat e përcaktuara
me dashje ose nga pakujdesia e tij.

Administratori në përputhje me nevojet e organizimit dhe të vepri
-mtarisë së SHPK ka të drejtë të emërojë përgjegjës të rojeve i cili
organizon dhe kontrollon punën e përditëshme dhe e përfaqëson adminis
-tratorin duke gëzuar dhe të drejta të tjerra.

Neni 18

Mardhënjet e punës në SHPK regullohen nga kotrata individuale e pu
punës, legjislacioni i punës dhe aktet e përcaktuar në nenin 16 të
këtij statuti.

Administratori ose përgjejgësi i rojeve kur ka të emëruar të till
nxjerr urdhëra e udhëzime për të cilat janë të detyrueshme për tu
zbatuar nga rojet, përveçse kur ato bien ndesh me aktet ligjore e nënl
-gjore në fuqi.

SHPK "Hoxha" është e detyruar të sigurojë në punënjësit në mënyrë
që të fitojnë të gjitha të drejtat sipas ligjit 7703 datë 11/5/1993
për sigurimet shoqërore " dhe VKM Nr 410 datë 31/12/1993 dhe të gji-
tha të drejtat e tjera të njohura me ligj.

Kreu II

Neni 19

Afati i veprimtarisë përcaktohet me licencë që SHPK do të marrë për
ushtrimin e aktivitetit të përcaktuar në këtë objket . Shoqëria mby
aktivitetin e saj me skadimin e afatit të licencës, anullimin e saj
nga organi kompetent, ose kur afati nuk përsëritet nga ky organ.

SHPK mund të mbyllë aktivitetin e saj edhe me vendimt të admin
-stratorit kur ajo nuk figuron rentabël. Kur SHPK mbyll aktivitetin
saj pasi shlyen të gjitha detyrimet ndaj shtetit e të të tretëve,
pjesa e mbetur e kapitalit dhe të ardhurat e realizuara nga veprimt
-ria disponohen nga administratori i saj. Po kështu përballohen edh
detyrimet e tjerra.

Kur mbyllet aktiviteti administratori cakton komisionin e liku
-dimit i cili përgatit bilancin e likuidimit dhe miratimin e të ci
nga administratori shoqëria pushon aktivitetin.

Kur licenca për zhvillimin e aktivitetit jepet nga organi i ca
nt, pa afat të caktuar firma e zhvillon aktivitetin pa afat të cak
dhe e pushon veprimtarinë me vendim të administratorit ose kur anu

licenca nga organi kompetent.

Neni 20

Ky xxxx statut përpilohet në pesë kopje nga të cilat një depozitohet në gjykatën e tiranës , një pranë noterisë Pogradec, një në degën e taksave Pogradec , një në degën e rendit publik dhe një arshivohet pranë SHPK.

Për të gjitha çështjet që nuk janë paraqitur në këtë statut zbatohen aktet ligjore e nënligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e shërbimit të rojeve civile në Republikën e Shqipërisë, rregullat e brendshme të objekteve dhe urdhërat e udhëzimet e administratorit të cilat evidentohen në regjistrin përkatës.

Administratori i SHPK " Hoxha "

/ Ilir Njazi Hoxha /

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE POGRADEC
NOTER THOMA BICJA
NR 241 Rep.

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Pogradec,sot ne date 02.06.1998,para meje noterit Thoma Bicja u paraqit personalisht shtetasi Ilir Njazi Hoxha,i datelindjes 1955,madhor me zotesi te plote per te vepruar,per identitetin e te cilit u sigurova ne baze te leternjoftimit te tij nr.119102, i cili nenshkroi para meje noterit statutin e Shoqerise me Pergjegjsi te Kufizuar "Hoxha".

NOTERI
Thoma Bicja

REPUBLIKA E SHQIPERISE THOMA BICJA NOTER POGRADEC

PULLE TAKS... 20 LEK R.SHQIPERI...

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Pogradec 2.Qershor.1998

BANKA KURSIMIT

V E R T E T I M

Vërtetojmë se Z. Ilir Njazi Hoxha ka ngurtesuar ne Banken e Kursimit shumën 100.000Leke( Njeqind mijë leke), për nxjerje License.

E lëshojmë këtë Vërtetim me kërkese të klientit.

DREJTOR I BANKES SE KURSIMIT

Alfred [illegible]

BANKA E KURSIMEVE
POGRADEC
02.06.1998
362/600/01

REPUBLIKA E SHQIPERISE

SHOQERIA" IRAL " SHPK

P O G R A D E C

V E N D I M

I

ORTAKUT TE VETEM nr. 2 date 20.10. 2002

Sot ne daten 22 Tetor 2002 une Ortaku i vetem, Administrator i Shoqerise " IRAL " SHPK,

V E N D O S A :

1. Te caktoj drejtuesin Teknik te Shoqerise " IRAL " SHPK z. PETRIT ISA DIKA.
2- Te behen ndryshymet perkatese me vendim te gjykates se shkalles se pare Tirane ne Statutin dhe Aktin e themelimit te Shoqerise.

ORTAKU I VETEM

ILIR HOXHA

IRAL SHPK Pogradec Albania

50 LEKE R.SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE

ZYRA E NOTERISE POGRADEC

Nr. 3046 Rep.

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me daten 23/10/2002, para meje Noteri Athina Bicja u paraqit personalisht z.Ilir Njazi Hoxha administrator i shoqerise "IRAL"SH.P.K. Pogradec, i datlindjes 1955 lindur e banues ne Pogradec, madhor me zotesi te plote per te vepruar, per identitetin e te cilit m sigurova ne baze te leter njoftimit perkates i cili bebshkroi me vullnet te lire dhe pa vrejtje kerkesen sa me siper.

NOTERI
THOMA BICJA

19540/2

5 A Xhoxhaj 25 10 2002

K E R K E S E

KERKUESI :Ilir Njazi Hoxhe i datlindjes 1955 lindur e banues ne POGRADEC,, Administrator i Shoqerise " ~~MO~~ I R A L " SHPK

OBJEKTI : Kerkoj depozitimin e Vendimit nr. 2 date 20 Tetor 2002 te Ortakut te vetem per caktimin e drejtuesit teknik ne baze te Ligjit " Mbi regjistrin Tregetar" me nr. 7667. si dhe Ligjit nr. 8370 date 19.04. 2001.

(2)

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE

T I R A N E

Me vendimin nr. 19540 /I date 15.10. 2001 te Gjykates se rrethit Tirane eshte vendosur caktimi i drejtuesit teknik te Shoqerise " IRAL " SHPK z. Kristaq Pasko Divjake , Shoqeri e cila eshte regjistruar me vendimin e po kesaj Gjykate me nr. 19540 si person juridik privat per ushtrimin e aktivitetit privat:

" Sherbimi i ruajtjes dhe i sigurise civile, per sigurimin e objekteve publike private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike e juridik me veprimtari ne Republiken e Shqiperise, sigurimin dhe mbeojtjen e jetes e shendetit te personave fizike, shtetas shqip tar ose te huaj qe kerkojne mbrojtjen e objekteve te jetes se tyre,etj Tregetimin e artikujve te ndryshem me shumice e pakice, importimin eksport te mallrave industriale e ushqimore bar bufe e restorant, etj"

Me vendimin nr. 2 te Ortakut te vetem eshte vendosur ndryshim i drejtuesit teknik te shoqerise " Iral " SHPK ne vend te Kristaq Divjakes vendoset Petrit Isa Diko.

Kerkoj pranimin e kerkeses duke u bere ndryshimet perkatese ne Statutin dhe Aktin e themelimit te shoqerise.

Beshkelidhur vendimin nr. 2 te Ortakut te vetem.

K E R K U E SI

Ilir Hoxhe Administrator i Shoqerise " IRAL " SHPK

" IRAL " SHPK Pogradec Albania




# K Ë R K E S Ë

Gjykatës së Rrethit
T I R A N Ë

KËRKUESI : Ilir Hoxha i datëlindjes 1955, i biri i Njaziut e i Hajries me banim në lagjen Nr 3 Pallati 65 në qytetin e Pogradecit , madhor , me zotësi juridike për të vepruar paraqet këtë kërkesë me:

O B J E K T I : Regjistrimi si person jurudik të SHPK (Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar) me emërtim " Hoxha", I Hoxha Pogradec në mbë--shtetje të ligjit Nr 7512, datë 10/8/1991 "Për sanksionimin e mbrojtj e pronës private, nismës së lirë e veprimtarisë private të pavarur", ligji Nr 7696, datë 7/4/1993, "Për shërbimin e rojeve civile", vendimi të Këshillit të Ministrave Nr 210 , datë 10/5/1993"Përshërbimin e roje civile" me objekt ruajtja e objekteve në pronësi ose përdorim të perso--nave juridikë e fizikë shqiptarë a të huaj, ruajtjen e rendit në këto objekte e sigurimin e jetës së personalit e të vlerave pasurore të tyr gjatë lëvizjes.

Bashkëlidhur me kërkesën po ju dërgojmë Statutin e SHPK " Hoxha " dhe aktin e themelimit.

K Ë R K U E S I
Ilir Hoxha

Të regjistrohet kërkesa. dt. 03-06-98 Gjyqtare M. Dedej

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE POGRADEC
NOTER THOMA BICJA
NR 242 Rep.

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Pogradec,sot ne date 02.06.1998,para meje noterit Thoma Bicja u paraqit shtetasi Ilir Njazi Hoxha,i datelindjes 1955,banues ne Pogradec, madhor me zotesi te plote per te vepruar,i cili nenshkroi kerkesen drejtuar Gjykates se Rrethit Tirane per regjistrimin si person juridik te SH.P.K "Hoxha" para meje noterit.

NOTERI
THoma Bicja



19540/1

15.10.2001

# KERKESE

3 A Hoxha
10.10.2001

12 OTT. 2001

**KERKUESI**: Ilir Njazi HOXHA i datëlindjes 10 shtator 1955, lindur ne Pogradec banues ne Lagjen nr.3, administrator SH.P.K. "HOXHA"

**OBJEKTI** :Kerkojne depozitimin e Vendimit nr .1 te 30.08.2001 te ortakut te vetem i cili ne baze te Ligjit nr.8770 date 19.04.2001 "Per shoqerit e Sigurimit e te ruajtjes fizike " si dhe te Udhezimeve te Ministris se Rendit Publik Nr.1487,1488,1489,1490,1491,1492, te dates 21.06.2001 cakton drejtuesin teknik.

GJYKATES SE RRETHIT

**TIRANE**

Me vendimin e Gjykates te Rrethit Tirane nr.19540 te dates 3.6.1998 eshte regjistruar si Person Juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar" HOXHA " SH.P.K me ortak te vetem dhe administrator Ilir Njazi HOXHA me seli ne lagjen nr.3 te qytetit Pogradec, dhe me kapital 100000 leke,me kohzgjatje mbi 10 vjet dhe me objekt te veprimtaris se saj:

*"Sherbimi i ruajtjes dhe i sigurise fizike :per sigurimin e objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizik e juridik me veprimtari ne Republiken e Shqiperise,sigurimin dhe mbrojtjen e jetes e shendetit te personave fizike , shtetas shqipetar ose te huaj , qe kerkojne mbrojtjen e objekteve e te jetes se tyre."*

Ne baze te Ligjit nr.8770 date 19.04.2001 "Per shoqerit e Sigurimit e te ruajtjes fizike " si dhe te Udhezimeve te Ministris se Rendit Publik Nr.1487,1488,1489,1490,1491,1492, te dates 21.06.2001 : Me Vendimin nr.1 date 30.08.2001 te ortakut te vetem te shoqerise:

Sa me siper i kerkoj kesaj Gjykate.te miratoje :

- ***Te ndryshoj emerin e shoqerise nga" Hoxha" ne"IRAL" SH.P.K.***
- ***Te caktoj drejtusin teknik te shoqerose "I R A L " Sh.p.k: z.Kristaq Pasko DIVJAKA:***

- ***Shtimi i kapitalit themeltar te shoqerise nga 100000 leke (njeqimd mije ) ne 4000000 leke (kater milion ),ne baze te kerkesave te caktuara nga ligji.***

ADMINISTRATORI
( Ilir Njazi HOXHA )

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA POGRADEC
No. 2969 rep.

VERTETIM

Sot më datë 20.09.2001 u paraqit para meje noter Thoma Bicja ,personalisht z. Ilir Njazi HOXHA ,për identitetin e të cilit u njoha nëpërmjet dokumetit të indentifikimit,te cilet më deklaroj se jashtë kësaj zyre është përgatitur ky vendim e të cilin e nënshkroj rregullisht me vullnet të lirë atë,pranë meje të cilën unë e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTERI
( Thoma Bicja )

PULLE TAKSE 50 LEKE SHQIPERISE

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**SHPK"I R A L"**
**POGRADEC**

## KONTRATE-PUNE

Sot me daten 20.10.2002,hartohet kjo kontrate ndermjet:

***Drejtuesit Ligjor:***

Ilir Njazi HOXHA lindur me 10 shtator 1955 ne Pogradec,banues ne lagjen nr.1 me arsim te larte , me cilesine e **drejtuesit ligjor** dhe net e njejten kohe dhe Administrator i shoqerise se sigurimit e ruajtjes fizike "IRAL" SH.P.K

***Drejtuesit teknik:***

Petrit DIKO i datelindjes 20 shtator 1964 me profesion Oficer, diplimuar prane Shkolles se Larte te Ministrise se Rendit ne Tirane ne vitin 1993-1997.
Kontrata lidhet mbi keto kushte duke marre persiper te drejta e detyrime seicila pale sipas detyrimeve si me poshte:

***Drejtuesit Ligjor:***

- Sigurimin e kushteve te plot ate punes sipas profesionit te Oficerit z.Petrit DIKO per realizimin e detyravene aspektin teknik ne perputhje te plote me kerkesat ligjore ne fushen e ruajtjes se sigurise fizike.
- Te realizoj pagesen mujore ne masen 10000 leke (dhjetemije) dhe per cdo ndryshim te lidhet kontrate tjeter.
- Te beje sigurimin prane organeve te sigurimeve shoqrore sipas ligjit nr.7703 dt.11.05.1993 "Per Sigurimet Shoqerore"
- Gjithashtu shoqria mer persiper krijimin e te gjitha kushteve qe garanton ligjin ne lidhjen e kesaj kontrate.

***Drejtuesit teknik:***

- Zbatimin e plote te detyrave e rregullave qe percakton Ligjit nr.8770 date 19.04.2001"Per shoqerite e Sigurimit e te ruajtjes fizike"si dhe te

Udhezimeve te Ministrise se Rendit Publik nr.1484,1488,1489,1490,1491,1492 te dates 21.06.2001 i cili do te zbatoje te gjitha detyrat funksionale te caktuara nga ligji.

- Te jete korrekt ne pune dhe ne cdo kohe te interesohet per mbarevajtjen e firmes duke punuar me korektesi te larte si dhe duke parandaluar dhe moslejimin e asnjelloj shkelje te karakterit teknik e normative

Afati i kesaj kontrate eshte njevjecar me te drejten e perseritjes cdo vit.Kontrata prishet ne moment kur shkelen kerkesat e ligjit dhe me deshiren e paleve.

Kontrata hartohet ne kater kopje,nga nje seicili person dhe nje dergohet ne Ministrine e Rendit Publik dhe konkretisht zyres se Licensave dhe nje kopje zyres se noterise.

*Drejtuesi teknik*
( Petrit Diko)

*Drejtuesi Ligjor*
(Ilir Njazi HOXHA)

IRAA SHPK
Pogradec Albania

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
NOTERIA POGRADEC
No.-1246-rep.

VERTETIM

Sot me dt.20.10.2002 u paraqiten prane meje noter-[illegible]----- ,personalisht z.Ilir Njazi HOXHA,z. Petrit Isa DIKO, per identitetin e te cileve u njoha nepermjet dokumentit te identifikimit te cilet me deklaruan se jashte kesaj zyre eshte pergatitur kjo kontrate e mesiperme te cilen e nenshkrojten regullisht me vullnet te lire ate,prane meje te cilen une vertetoj ate sipas ligjit.

**NOTERI**
( [illegible] )



3 A Xhoxha
19 12 2002

# KERKESE

**KERKUESI:**ILIR NJAZI HOXHA i datelindjes 1955, lindur ne Korce e banues ne Pogradec,Administrator i Shoqerise "IRAL''SHPK

**OBJEKTI:** Kerkoj depozitimin e Vendimit nr.4 date 20/Tetor 2002 te Ortakut te vetem per caktimin e drejtuesit teknik ne baze te Ligjit "Mbi regjistrin Tregetar'' me nr.7667. te Ligjit nr.8770 date 19.04.2001 si dhe udhezimit te M.R.D nr_______ dt.__________.

**GJYKATES SE SHKALLES SE PARE**

TIRANE

Me vendimin nr.19540/2 date 25.10.2001 te Gjykates se rrethit Tirane eshte vendosur caktimi i drejtuesit teknik te Shoqerise ''IRAL'' SHPK z. Petrit Isa Diko,Shoqeri e cila eshte regjistruar me vendimin e po kesaj gjykate me nr.19540 si person juridik privat per ushtrimin e aktivitetit privat:

"Sherbimi i ruajtjes dhe i sigurise civile ,per sigurimin e objekteve publike private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike e juridike me veprimtari ne Republiken e Shqiperise,sigurimin dhe mbrojtjen e jetes e shendetit te personave fizike ,shtetas shqiptare ose te huaj qe kerkojne mbrojtjen e objekteve,te jetes se tyre etj.

Me vendimin nr.3 te Ortakut te vetem eshte vendosur heqja e drjetuesit teknik te shoqerise "IRAL'' SHPK dhe te vendoset Ilir Njazi Hoxha.

Kerkoj pranimin e kerkeses duke u bere ndryshimet perkatese ne Statutin dhe Aktin e themelimit te shoqerise.

Bashkalidhur vendimin nr. 3 te Ortakut te vetem

**KERKUESI**

Ilir Njazi Hoxha Administrator i Shoqerise "IRAL'' SHPK

"IRAL" SHPK
Pogradec Albania

SHKOLLA E LARTË E BASHKUAR E
OFICERËVE "ENVER HOXHA„



# DIPLOMË

Nr. 1230

Shoku Ilir Nazi Hoxha

mbaroi studimet në vitin 1978

në fakultetin e Artilerisë

të Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve "Enver Hoxha„

Me vendim të komisionit shtetëror

Nr. 33 datë 27.5.1978

diplomohet oficer për specialitetin

Artileri Kundërajrore

| KOMISARI | KOMANDANTI |
|---|---|
| Agron Dushku | (Rustem Peçi) |

Tiranë, më 29.5.1978

Nr. i Regj. 1257

REPUBLIKA E SHQIPERISË
DHOMA E NOTERËVE
Nr 3381 Rep Dt 10.12.2002
VERTETIM
Vërtetohet se fotokopja është e njëjtë me origjinalin Dokument
u paraqit nga I. Hoxha
Nr Pasap
NOTER THOMA BICJA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR 3351 REP.DT 13.12.2002
VERTETIM
VERTETOHET NJESIA
ME ORIGJINALIN
AL Notere DRITA PEPI

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**SHOQERIA "IRAL" SHPK**
**POGRADEC**

VENDIM:

**I**

**ORTAKUT TE VETEM nr. 3 dt.10.12. 2002**

Sot me daten 10.12.2002 une Ortaku i vetem,Administrator i Shoqerise "IRAL" SHPK,

**VENDOSA:**

1.Te heq drejtuesin Teknik te Shoqerise "IRAL" SHPK z.Petrit Isa Diko.

2.Te behen ndryshimet perkatese me vendim te gjykates se shkalles se pare Tirane ne Statutin dhe Aktit te themelimit te Shoqerise.

ORTAKU I VETEM
ILIR HOXHA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NOTERE DRITA PEPI
NR 3654 Rep

VERTETIM

Vertetoj se sot me date 17 12 .2002 para meje Notere Drita Pepi,me Adrese ne Bulevardi Zhan D'Ark,Tirane u paraqiten personalisht Shtetesi

I. Ilir Niazi Hoxha ,lindur ne Korce me date 10.09.195 mr banim ne Pogradec,madhore me zotesi juridike per te vepruar per , identitetin e te cilit u sigurova me ane te deshmise se aftesise me nr 688931 para meje nenshkroi vendimin e ortakt te vetem me nr 3 date 10.12.2002 , une noteria vertetoj firmen e saj sipas ligjit.

NOTERE
DRITA PEPI

1954/4 Ariano Ceco 13 01 2006

# KËRKESË

**KËRKUESI:** Adil AGOLLI , në cilësinë e administratorit të shoqërisë " IRAL " Shpk Pogradec .

**OBJEKTI I KËRKESËS** : Pranimin e Vendimit të ortakut të vetëm të shoqërisë Nr. 4 datë 30.12.2005, për ndryshimit e pronësisë nëpërmjet dhurimit të 100 % të kapitalit të nenshkruar , konformë nenit 58 , të Ligjit Nr. 7638 datë 19.11.1992 " Për shoqëritë tregëtare ".

## GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR
## TIRANË

Shoqëria " IRAL " Shpk është rregjistruar për të ushtruar aktivitet në qytetin e Pogradecit me Vendimin e Gjykatës së Tiranës me Nr. 19.540 datë 03.06.1998 , e themeluar nga ortaku i vetëm Ilir HOXHA , me emërtimin e parë " HOXHA" Shpk , i ndryshuar me Vendimin Nr 19.540/1 datë 15.10.2001, me kapital themeltar prej 100.000 lekë i zmadhuar në 4.000.000 lekë po me vendimin e cituar , me objekt veprimtarie " Në fushën e ruajtjes së objekteve në pronësi ose në përdorim të personave juridike e fizike, shqiptar dhe të huaj, ruajtja e rendit në këto objekte dhe sigurimi i jetës së personelit e tyë vlerave pasurore të tyre gjatë lëvizjes ".

Me Vendimin e ortakut të vetëm të shoqërisë Nr. 4 datë 30.12.2005, është bërë miratimi i Kontratës së Dhurimit Nr. 193 rep. 47 kol. datë — .12.2006, ku ortaku Ilir HOXHA , dhuron 100 % të kapitalit themeltar të nënshkruar , të shoqërisë duke u larguar nga shoqëria, dhe përfituesi Adil AGOLLI , i cili përfiton 100 % të kapitalit themeltar dhe bëhet ortak i vetëm në shoqërinë " IRAL " Shpk Pogradec . Me këtë rast është emëruar Administrator i shoqërisë z. Adil AGOLLI .

Përsa më sipër, kërkohet të depozitohen Vendimi i ortakut të vetëm Nr. 4 të datës 30.12.2005 si dhe kontrata e dhurimit Nr. 193 rep. 47 kol. e datës . .12.2006 .

Të depozitohet. kërkesa dt 18.01.2006 — Vendimi Nr 4 dt 30.12.2005 — kontrata dhurimi nr. 193 rep 47 kol.

**Pogradec**, më 30.12.2005

**ADMINISTRATOR I SHOQËRISË**

( Adil AGOLLI )

Gjyqtare Ariana Caco

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTER PUBLIK
Nr 194 rep.

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me daten 12.01.2006 , para meje noterit Drita Pepi , u paraqit shtetasi - Adil AGOLLI , i datëlindjes 1962, lindur dhe banues në Tiranë , madhor dhe i aftë për të kryer veprime juridike, i cili deklaroi se eshte dakort me kerkesen e mesiperme, te cilen e ka nenshkruar me doren dhe me vullnetin e tij te lire e te pavesuar, duke kerkuar noterizimin e saj.

Nga ana ime nuk shihet ndonje pengese ligjore, prandaj vertetoj sa me siper dhe noterizoj.

Noteri

( NOTERE DRITA PEPI TIRANE )

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË**
**"IRAL" Shpk Pogradec**

# V E N D I M
## Nr. 4 datë 30.12.2005

Mbledhja e Ortakut të vetëm të shoqërisë "IRAL "SHpk e përbërë nga :

- Ilir HOXHA, që zotëron 100 % të kapitalit të nënshkruar në vlerë 4.000.000 lek, i cili dhuron pjesën dhe largohet nga shoqëria ;
- Adil AGOLLI , në cilësinë e pranuesit të Dhurimit të kapitalit në pronësi të ish ortakut Ilir HOXHA, dhe bëhet Ortak i vetëm i kësaj shoqërie ;

konformë Ligjit Nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare" si dhe rregullave të përcaktuara në Statutin e shoqërisë, mori në shqyrtim rendin e ditës :

- Miratimin e kontratës së Dhurimit Nr/193 rep 47 kol. datë .. 12/2006
- Emërimin e Administratorit të shoqërisë .

**Përsa më sipër:**

Në bazë të statutit dhe nenit 58 të ligjit 7638 datë 19.11.1992 " Për Shoqëritë tregëtare", Mbledhja e Ortakut të vetëm të Shoqërisë,

**V E N D O S I**

1. Miratohet Kontrata e Dhurimit Nr/193 rep 47 kol. datë .. .12/2006 , sipas së cilës ortaku Ilir HOXHA , i dhuron 100 % me vlerë 4.000.000 lekë, të kapitalit të nënshkruar, që zotëron në shoqërinë " IRAL " Shpk duke u larguar nga shoqëria , zotit Adil AGOLLI , i cili përfiton 100 % të kapitalt të nënshkruar , duke hyrë dhe bërë ortak i vetëm në këtë shoqëri, me pjesëmarjje 100 % ose 4.000.000 lekë , të vlerës së kapitalit të nënshkruar .
2. Rregullat e përcaktuara në Aktin e themelimit si dhe Statutin e shoqërisë , të depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë , të qëndrojnë të pa ndryshuara.
3. Emërohet Administrator i Shoqërisë " IRAL " Shpk z. Adil AGOLLI .
4. Të përpilohen dhe depozitohen aktet në rregjistrin tregetar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË**
**" IRAL " Shpk**

| ORTAKU QË NGELET NË SHOQËRI | ORTAKU QË LARGOHET NGA SHOQËRIA |
|---|---|
| ( Adil AGOLLI ) | ( Ilir HOXHA ) |

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTER PUBLIK
Nr 195 rep.

TAKSA LIKUJDUA

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me datën 12.01.2006, para meje noterit Dritë Pepi u paraqitën shtetasit:

- Adil AGOLLI , lindur dhe banues në Tiranë, ortaku që ngelet në shoqërinë "IRAL " Shpk Pogradec, si dhe ortaku që largohet nga shoqëria Ilir HOXHA , lindur dhe banues në Pogradec, të dy madhorë dhe të aftë për të kryer veprime juridike , - të cilët deklaruan se janë dakort me Vendimin si më sipër, të cilin mbas miratimit, e kanë nënshkruar vetë me dorën e tyre , me vullnet të lirë e të pavesuar dhe kërkuan noterizimin e tij.

Nga ana ime nuk shihet ndonjë pengesë ligjore, prandaj vërtetoj sa më sipër dhe noterizoj.

Noteri

( Dritë Pepi )

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTER PUBLIK
Nr. 193 rep.
Nr. 47 kol.

TAKSA U LIKUJDUA

# KONTRATE DHURIMI

Sot më datën .12.2005 në Tiranë para meje noter Drita Pepi u paraqiten personalisht shtetasit :

1- Ilir **HOXHA** , i datelindjes 1955 , lindur dhe banues në qytetin e Pogradecit , në cilësinë e Dhuruesit 100 % të pjesës së kapitalit të nënshkruar që zotëron në Shoqërinë " IRAL " Shpk Pogradec , i cili largohet nga shoqëria ;

2- **Adil AGOLLI** , i datelindjes 1962, lindur dhe banues në qytetin Pogradecit , në cilësinë e Përfituesit të 100 % të pjesës së kapitalit të nënshkruar , duke hyrë në cilësinë e ortakut të vetëm në shoqërinë " IRAL" Shpk Pogradec.

Shoqëria " IRAL " Shpk është rregjistruar për të ushtruar aktivitet në qytetin e Pogradecit me Vendimin e Gjykatës së Tiranës me Nr. 19.540 datë 3.6.1998 , e themeluar nga ortaku i vetëm Ilir HOXHA , me emërtimin e parë " HOXHA" Shpk , i ndryshuar me Vendimin Nr 19.540/1 datë 15.10.2001, me kapital themeltar prej 100.000 lekë i zmadhuar në 4.000.000 lekë po me vendimin e cituar , me objekt veprimtarie " Në fushën e ruajtjes së objekteve në pronësi ose në përdorim të personave juridike e fizike, shqiptar dhe të huaj, ruajtja e rendit në këto objekte dhe sigurimi i jetës së personelit e tyë vlerave pasurore të tyre gjatë lëvizjes ".

Z. Ilir HOXHA , si ortak themelues i shoqërisë "IRAL" Shpk Pogradec , zotërues i 100 % të kapitalit themeltar të nënshkruar në Shoqëri , me vullnet të lirë , konformë ligjit dhe rregullave të përcaktuara në Statutin e shoqërisë , dëshiron që pjesën e kapitalit themeltar që zotëron në këtë shoqëri , t'ja dhuroje z . Adil AGOLLI , i cili bëhet Ortak i vetëm në shoqërinë " IRAL " Shpk, dhe vetë të largohet nga pronësia dhe pjesëmarrja në shoqëri .

Nga ana e tij Përfituesi i dhurimit zoti Adil AGOLLI , deklaron se pranon dhurimin 100 % të kapitalit themeltar të nënshkruar i shoqërisë " IRAL " Shpk, që i dhuron ish ortaku themelues Ilir HOXHA , duke qenë mirënjohës ndaj tij . Prej këtij momenti pranuesi i dhurimit Z. Adil AGOLLI , bëhet zotërues 100 % të vlerës së kapitalit themeltar të nënshkruar të shoqërisë "IRAL" Shpk Pogradec, dhe për çdo detyrim të lindur në emër të shoqërisë , sipas pjesëmarrjes në kapital dhe sipas rregullave të Statutit të Shoqërisë , si për periudhën e kaluar dhe atë në vazhdim do të përgjigjet vetë si pronar i shoqërisë .

Kësaj kontrate i bashkangjitet një kopje e vendimeve Nr. 19.540 datë 3.6.1998 të Gjykates së Rrethit Tiranë dhe një kopje e Vendimit 4 të datës 30.12.2005 të ortakut tëvetëm të shoqërisë " IRAL " Shpk Pogradec.

Kontrata u lexua prej sejcilit pjesmarrës, të cilët n basi e gjejnë të përpiluar sipas vullnetit të tyre, e nënshkruajnë atë.

ORTAKU DHURUES
( Ilir HOXHA )
Ilir Hoxha

ORTAKU PRANUES I DHURIMIT
( Adil AGOLLI )
Adil Agolli

NOTERI
( ____________________ )

NOTERE
DRITA PEPI
TIRANE

PULLE TAKSE
50 LEKE
R. SHQIPERISE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
THOMA E NOTERËVE
Nr 3296 Rep Dt 8.10.2001
VERTETI M
Vërtetohet se fotokopja është e njëjtë me origjinalin Dokument i paraqit nga K. Divjaka
Nr. Pasap.
NOTER THOMA BICJA

# DIPLOME

Seria Nr. "76"

*Studenti* Kristaq Pashko Divjaka
*Filloi* 1983
*Përfundoi* 1987

*Shkollën e Lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme.*

*Me vendim të Komisionit të Provimit të Formimit datë* 25.6.1987 *u diplomua në degën* Polici

KRYETARI I KOMISIONIT
(Dilaver Bengasi)

KOMISARI I SHKOLLES — KOMANDANTI I SHKOLLES
(Spiro Shuke) — (Llazar Gjonca)

Tiranë, më 25.6.1987 Nr. i regjistrit: 1107

BANKA E KURSIMEVE SH.A.
DEGA E BANKES KURSIMEVE
POGRADEC

Pogradec me 19.Shtator 2001

# V E R T E T I M

Vertetojme se Z. Ilir Njazi Hoxha ka depozite kursimi ne valute , ne Degen e Bankes Kursimeve Pogradec , nje depozite ne Dem , pa afat , me nr libreze 1624 , me shumen 33000 Dem ( tridhjetetremije Marka Gjermane ), dhe nje depozite ne GRD, pa afat, me nr 1625 , me shumen 5 180 000 GRD ( pesemilionnjeqindtetedhjetmije Dhrami Greke ).
E konvertuar ne lek kjo depozite eshte e barabarte me 4 000 000 lek .
Kjo shume eshte gjendje sot me date 19.Shtator 2001 .

E leshojme kete vertetim sipas kerkeses se vete depozituesit .

Alfred DISHNICA
DREJTOR I DEGES BANKES

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKES E KURSIMEVE
DEGA POGRADEC